



Drejtoria për Urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit
Odelenje za Urbanizam, Planiranje i zaštitu sredine

12 . Nr. 20
Rahovec, 11.04.2018

Drejtoria për Urbanizëm, planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit duke shqyrtuar kërkesën **Fitim Krasniqi nga Senoci** me 12Nr.20 të datës 21.03.2018 duke u bazuar në nenin 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nr 03/L-25, të datës 26.02.2009 nenit 5,6,12 dhe shtojcës e Udhëzimit Administrativ për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale Nr. 01/2017 të datës 02.05.2017, neneve 3, 4, 5 të Rregullores Komunale për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale 01Nr. 906 të datës 30.03.2016 dhe neneve 3, 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative Nr.05/L-31 të datës 05.05.2016 , kjo Drejtori – Sektori për Mbrojtjen e Mjedisit lëshon këtë:

V E N D I M

LEJE MJEDISORE KOMUNALE

I Lejohet kërkesa e **Fitim Krasniqi nga Senoci** për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale për Objektin Afarist N.T.H ,Fitimi -Resturan, Senoc KK –Rahovec shfrytëzues i pronës së Radumi (Rrustem) Veli ngastra kadastrale nr.107-0 te evidentura në certifikatën nr.P-71510071 te vendi i quajtur Rahishte me sipërfaqe 2735 m2 tokë bujqësore arë e klasit 5 zona kadastrale Senoc.

II. Leje mjedisore komunale do të pushojë të prodhojë efekte juridike nëse parashtruesi i kërkesës ose investitori nuk fillon realizimin e projektin në afat prej **2 viti** nga dita e marrjes të kësaj leje.

A r s y e t i m

Drejtoria për Urbanizëm –Sektori për Mbrojtjen e Mjedisit duke shqyrtuar kërkesën dhe shkresat e lëndës Nr 22 të datës 21.03.2018, procesverbalit nga gjendja faktike në terren me nr. 22 të datës 10.04.2018, konstaton se janë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara me rregullativën në fuqi, prandaj është vendosur sikurse në dispozitiv.

UDHËZIM JURIDIK : Kundër këtij Vendimi - Leje Mjedisore Komunale pala e pakënaqur mund të ushtrojë në afat prej **15 ditë** Ankesë në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nga dita e dorëzimit të këtij Vendimi - Lejes Mjedisore Komunale, Ankesa dozohet përmes kësaj Drejtorie - Sektorit për Mbrojtjen e Mjedisit, e taksuar **1 Euro**.

Drejtori

Rumir Zhuniqi

